

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2025

KUALIFIKIMI PROFESIONAL "PËRPUNIM DRURI"

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Kërkesa	9	10	11	12	13	14	15	16
Pikët								
Kërkesa	17	18	19	20	21	22	23	24
Pikët								
Kërkesa	25	26	27	28	29	30		
Pikët								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

-
1. Në cilin grup të drurëve me teksturë bën pjesë druri i panjës? 1 pikë
- A) Teksturë shumë të hollë
B) Teksturë të hollë
C) Teksturë gjysmë të ashpër
D) Teksturë të ashpër
2. Sipas masës vëllimore cili nga drurët e mëposhtëm është më elastik? 1 pikë
- A) Lisi
B) Pisha e bardhë
C) Bredhi
D) Pisha e zezë
3. Në cilën pjesë të pemës ndeshen defekte të drurit nga fibra e shmangur? 1 pikë
- A) Kurorë
B) Në majë të degëve
C) Në mes të degëve
D) Në nisje të degëve
4. Te cilët lloje ngjitësish futet xhelatina apo tutkalli i lëkurës? 1 pikë
- A) Lëndë ngjitëse me origjinë sintetike
B) Lëndë ngjitëse me origjinë bimore
C) Lëndë ngjitëse me origjinë shtazore
D) Lëndë ngjitëse me origjinë minerale
5. Në menteshën e fshehtë kunj metalik shërben si: 1 pikë
- A) Aks përdredhës
B) Aks mbështetës
C) Aks rrotullimi
D) Aks përkulës
6. Në tapiceri për eliminimin e zhurmave, susta mbështetet: 1 pikë
- A) Në rripa dërrase
B) Në rripa tekstili të vendosur mbi rripa dërrase
C) Mbi gozhdë në formë U-je
D) Mbi krina
7. Cili është diametri i diskut prerës të sharrës së mekanizuar të dorës: 1 pikë
- A) 140—240mm
B) 240--- 280mm
C) 280---300mm
D) 300---350mm
8. Drejtuesja e sipërme te makina sharrë shirit shërben për: 1 pikë
- A) Drejtimin e detalit
B) Drejtimin e volantëve
C) Drejtimin e shiritit
D) Drejtimin e tapës
9. Makina plan drejtuese shërben për: 1 pikë
-

- A) Nxjerrjen në trashësi të njëlojtë të detaleve
- B) Punon me ndihmën e shabllonit
- C) Punon pas makinës grosecë
- D) Drejton brinjën e detalit prej druri

10. Sa duhet të jetë trashësia e shtresës së drurit të hequr gjatë një kalimi në makinën grosecë? **1 pikë**

- A) 1.5 - 2.0mm
- B) 2.1 - 2.5mm
- C) 2.6 - 3.0mm
- D) 3.1 - 3.5mm

11. Në makinën frezuese me bosht vertikal nga poshtë, skuadra është e formuar nga: **1 pikë**

- A) Një pjesë e vetme
- B) Dy pjesë
- C) Një skuadër e pjerrët
- D) Një pjesë druri e fortë

12. Në makinat e shpimit të drurit, gjatësia e vrimës së hapur në dru përputhet me: **1 pikë**

- A) Trashësinë e thithit
- B) Shtresëzimin e thithit
- C) Gjatësinë e thithit
- D) Gjerësinë e thithit

13. Për të plotësuar pllakën prej druri, rripat prej druri që ngjiten duhet të jenë të gjerë: **1 pikë**

- A) 1mm - 100mm
- A) 101mm - 200mm
- B) 201mm - 300mm
- C) 301mm - 400mm

14. Cili nga emërtimet e mëposhtëm të pjesëve të objektit është elementi? **1 pikë**

- A) Kutia
- B) Pllakat
- C) Detali
- D) Korniza

15. Krevati është pjesë e mobilies së shtëpisë për: **1 pikë**

- A) kuzhinën
- B) dhomën e gjumit
- C) dhomën e ndenjjes
- D) sallonin e pritjes

16. Lidhjet zdrukthëtare kryhet nga futja te njëra-tjetra në mënyrë të saktë e një: **1 pikë**

- A) detali të tërë në detalin tjetër
- B) pjese detali në detalin tjetër
- C) pjese detali në të njëjtin detal
- D) pjese detali në folenë e detalit tjetër

17. Cilët janë pjesë të strukturës së kostos së prodhimit të objektit prej druri? **1 pikë**

- A) Materialet kryesore prej druri dhe metalike
- B) Kutia
- C) Kompleksi
- D) Telajo

18. Syprina e një tavoline me gjerësi 700mm me dru masiv, ndryshon përmasat në ambiente të mbyllura me: **1 pikë**

- A) 6 - 8%
- B) 8 - 10 %
- C) 10 -12 %
- D) 12 -14 %

19. Tharja natyrore përfundon kur lagështia e drurit është: **1 pikë**

- A) 10 - 19%
- B) 20 - 29%
- C) 30 - 40%
- D) 41 - 50%

20. Në repartet e montimit të mobilieve, përdoren transportierë me zinxhirë me shpejtësi: **1 pikë**

- A) 0.1m/s - 0.3m/s
- B) 0.3m/s - 0.5m/s
- C) 0.6m/s - 1.0m/s
- D) 1.1m/s - 2.0m/s

21. Si grupohen drurët sipas shkëlqimit të tyre? **4 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

22. Cilat janë llojet e gjendjeve të sasisë së lagështisë në dru? **4 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

23. Cilët janë dylërat kryesorë që përdoren në përgatitjen e pastave dyllosëse për lustrim?

4 pikë

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

24. Listoni 4 (katër) nga mjetet e mekanizuara të dorës që përdoren në përpunim e drurit.

4 pikë

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

25. Në cilat drejtime makinat sharrë rrethore (Disk) kryejnë prerjen e drurit.

4 pikë

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

26. Emërtoni 4 (katër) nga pjesët përbërëse të sharrës disk, që drejtohet me karel.

4 pikë

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

27. Emërtoni pjesët që përbëjnë thithin (mashkullin).

4 pikë

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

28. Rendisni llojet e lidhjeve zdrukthëtare të detaleve me dru masiv dhe të pllakave të ndryshme.

4 pikë

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

29. Cilat janë hapat e punës që kryhen për zbërthimin e një projekti me bazë druri.

4 pikë

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

30. Rëndësia ekonomike e tharjes së drurit përbëhet nga disa elementë: Listoni 4 (katër) prej tyre.

4 pikë

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

